

5 FAKTORË THEMELORË PËR MISION EFEKTIV

NGA TOD MOR



WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM

5 FAKTORË THEMELORË PËR MISION EFEKTIV

Problemi më i zakonshëm që dëgjoj, ndërsa punoj me kisha të të gjitha llojeve dhe përmasave në të gjithë botën, është: Si mund të ndihmojmë për t'i pajisur njerëzit tanë me atë çka nevojitet që të jetojnë si komunitet në mision (**me theksin te misioni**)?

Dua të sugjeroj pesë faktorë themelorë, që shoh se zakonisht mungojnë në kisha, në ndonjë formë që kërkon vëmendje dhe fuqizim të vazhdueshëm. Këto janë fusha themelore, ku shpesh mungon qartësia, qëllimi dhe fokusi.

Njerëz, Vende, Shpallje, Plani, Lutje

NJERËZ

Njerëz, të cilët janë jo të krishterët e veçantë (përafërsisht 10 deri në 15), që ti beson se Zoti e ka thirrur grupin tënd t'u përkushtohet, t'u kushtojë kohën më të mirë, dashuri, lutje dhe t'u shërbejë dukshëm përgjatë javës?

Grupi yt, duke u lutur së bashku, duhet të dallojë cilin Zoti po ju drejton t'i përkushtoheni së bashku. Këta mund të jenë:

- Fqinjë të afërt
- Fqinjë, që i keni takuar në një festë lagjeje
- Njerëz, që i keni takuar në park, në plazh ose në kafe
- Njerëz, që i keni takuar përmes shkollës së fëmijëve
- Njerëz, që i keni takuar përmes sporteve ose programeve jashtëshkollore të fëmijëve tuaj
- Kolegë të kompanisë suaj
- Njerëz, që i keni takuar duke ndjekur pasionet tuaja (vrap, muzikë, punët e dorës, palestër, peshkim, aktivitete të tjera).
- Njerëz, që i keni takuar si rrjedhojë e një nevoje për ndihmë, që ata kanë pasur (probleme shëndetësore, probleme ekonomike, probleme martesore, kujdes për fëmijët, ushqime, probleme me makinën, probleme familjare).

VENDE

Vende: Cilat janë vendet specifike dhe konteksti marrëdhënior, ku grupi yt do t'u përkushtohet rregullisht këtyre njerëzve?

Grupi yt duhet të lutet që të dallojë kohët më të mira, vendet dhe mënyrat për të kaluar kohë me njerëzit.

Çelsi është të përcaktosh kur dhe ku mund të kalosh kohë me ta në mënyrë të vazhdueshme dhe si një grup, që ka minimumi dy deri në tre pika kontakti çdo muaj. Të tilla si:

- Gatime në skarë në shtëpinë e dikujt çdo të premte.
- Organizoni një mbrëmje të hënën ose festë futbollit për meshkuj të dielën pasdite në lagje.



- Takim në të njëjtin park ose plazh për lojëra të martën në mëngjes.
- Piknik çdo të premte në mbrëmje (përpiquini ta bëni këtë në të njëjtin orar në pjesën më të madhe të kohës).
- Bëhuni pjesë e një grupi, që ka një program të qëndrueshëm, si palestra, vrapimi, xhirot me bicikleta ose ngjitjet në mal.
- Shfaqni qëndrueshmëri duke shkuar në të njëjtën kafene, pub apo restorant.
- Ndhmoni në shkollën e fëmijëve, skuadrën e sportit apo një klubi të caktuar.
- Duke u bërë pjesë e grupit të vigjilentëve në lagjen tuaj.

SHPALLJE

Shpallje: Si do t'ua shpallë grupi yt vazhdimisht ungjillin përmes fjalëve dhe veprave njerëzve me të cilët you po zhvillon miqësi?

Grupi yt duhet të lutet për të dalluar si ta shfaqë dhe si të flasë për dashurinë e Jezusit në mënyra praktike, krijuese dhe të qëndrueshme.

Për shembull, për të demonstruar ungjillin ju mund:

- T'u çoni biskota të sapobëra, bukë ose byrek.
- Të siguroni një vakt gjatë një mbrëmjeje, që ju e dini se ata do të jenë tepër të zënë.
- Të siguroni vakte të ndryshme për ta në periudha kur janë sëmurë, kur po ndryshojnë punë apo po kalojnë një kohë të vështirë.
- Të siguroni ushqime gjatë një jave tepër të zënë për ta ose ushqime, të cilat ata nuk e kanë të mundur t'i sigurojnë.
- T'i qerasni me kafe ose t'u bëni dhuratë një kartë, që mund ta përdorin për të dalë së bashku me bashkëshortët e tyre.
- T'i ndihmoni me një projekt shtëpie, projekt në oborr apo kopsht.
- T'i ndihmoni të rregullojnë ose pastrojnë diçka.

Për ta shpallur ungjillin me këta miq, ju mund:

- T'i ftoni për të studiuar Biblën me ju ose me disa të tjerë në grup.
- Të zhvillonin një diskutim rreth temave praktike si martesat, prindërimi apo financat nga një perspektivë biblike.
- T'u kërkoni të ndajnë me ju historinë e jetës së tyre në 30 minuta.
- Të ndani me ta historinë e jetës suaj në 30 minuta.
- T'i ftoni të përjetojnë diçka të ngjashme me historinë e Perëndisë.
- T'u kërkoni të ndajnë me ju kërkesa lutjeje.
- T'u tregoni praktikisht se si Zoti po i ndryshon jetët e njerëzve rreth jush dhe grupit tuaj.

PLANI

Plani: Cili është plani specifik javor dhe mujor sipas të cilit grupi juaj do të jetojë në komunitet me qëllimshmëri dhe fokusin e identifikuar më sipër?

Grupi juaj duhet që përmes lutjes të dallojë s'i t'i organizoni jetët dhe të krijoni një plan sipas të cilit të jetoni së bashku me qëllimshmëri. Qëllime të mira pa një plan specifik zakonisht çojnë në mungesë frytësh.

Ji specifik. Ji i qëndrueshëm. Ji i fokusuar. Grupi yt nuk duhet t'u përkushtohet 10 gjërave çdo muaj. Bëni disa gjëra në mënyrë të vazhdueshme me të njëjtët njerëz, por ato që bëni bëjini



mirë. Kujtohuni që qëllimi është që t'i thëlloni marrëdhëniet me tetë deri në 12 njerëz për të cilët Perëndia e ka thirrur grupin tuaj t'i dojë dhe t'u shërbejë.

Ndërsa planifikoni jini specifik për ditën, kohën dhe vendin, ku do të ndodhin ato, që keni planifikuar në mënyrë që grupi më pas të përshtatet në bërjen e planeve të veta mujore dhe të mund t'i ftojë më përpara miqtë e tyre. (Kur i ftojmë njerëzit në çastin e fundit nuk duhet të befsohemi kur ata thonë jo.)

Vendosni në cilat mbrëmje të javës miqtë tuaj janë të disponueshëm dhe bëni plane, që janë të qëndrueshme gjatë atyre netëve, plane të arsyeshme dhe jetëdhënëse për njerëz të zënë dhe të lodhur (sidomos nëse kanë fëmijë).

Përcaktoni në cilat orare gjatë fundjavës janë miqtë tuaj më të disponueshëm për të kaluar më shumë kohë në park, plazh, pishinë, për gatime në skarë, duke luajtur volejball, frizbi, lojëra në oborr, lojëra për fëmijë, xhiro me biçikleta, duke shkuar në evente, duke parë evente sportive, etj.

LUTJA

Lutja; Si do të lutet me fokus të qartë grupi yt për këta njerëz, vende dhe detaje?

Grupi yt duhet të dallojë në lutje se kur, ku, si dhe për kë do të lutet me një fokus qartë. Lutja është fuqia, që ndihmon për të ndryshuar zemrat dhe mendjet, duke sjellë kështu transformim të jetëve. Është karburanti për mision.

Krijoni një plan specifik lutjeje për çdo person, që do të lutesh, si do të lutesh për ta dhe sa shpesh do të përkushtohesh në lutje për ta. Përcakto kur do të luteni si grup për këta njerëz, sikurse dhe kur do të lutesh personalisht për ta. Mund të kujtoni njëri-tjetrin për lutje dhe të specifikoni për çfarë të luteni përmes emaileve, mesazheve apo Facebook-ut.

Po ashtu, mund ta përditësoni njëri-tjetrin për çka po ndodh në marrëdhënie të ndryshme apo edhe biseda, të cilat do t'ju inkurajojnë të luteni edhe më shumë për këta njerëz.



MISION EFEKTIV PËR GRUPIN TËND

5 PYETJE PËR T'IA DREJTUAR GRUPIT VAZHDIMISHT NË MËNYRË QË TË VLERËSONI, RIKUJTONI DHE INKURAJONI.

Përdoreni këtë hapësirë për t'iu kthyer përgjigje pyetjeve dhe angazhimeve, që do të merrni përsipër sezonin tjetër, tremujorin ose semestrin lidhur me mënyrat se si do t'i integroni jetët tuaja në mision me njerëz të caktuar. Shqyrtojeni në lutje çdo pyetje dhe referojuni artikujve të mëparshëm për ide.

1. **Cilët janë njerëzit, që Perëndia na ka thirrur t'i duam, t'u shkojmë pas dhe të lutemi?**

Cilët janë dhjetë deri në pesëmbëdhjetë njerëzit te të cilët komuniteti yt do të fokusohet?

2. **Në cilat vende specifike do të tregojmë dashurinë dhe përkushtimin kundrejt këtyre njerëzve?**

Ndërsa mendon për grupin e njerëzve, që ke identifikuar më sipër, me gjasa ka tashmë shumë vende ku keni kaluar kohë me ta. Cilat janë keto vende?

3. **Si po ua shpallim Ungjillin këtyre njerëzve në mënyrë të vazhdueshme përmes fjalës dhe veprave?**

Mendoni se si mund t'u tregoni dhe shpallni Ungjillin në shumë mënyra dhjetë deri në pesëmbëdhjetë njerëzve, që ka identifikuar grupi juaj.

4. **Cili është plani ynë javor dhe mujor, që po na mban të fokusuar tek ata te të cilët jemi dërguar?**

Ji i specifik. Ji i qëndrueshëm. Ji i fokusuar.

5. **Si po lutemi për këta njerëz dhe për detaje me fokus të qartë?**

Krijoni një plan lutjeje, që është specifik për çdo person për të cilin po lutesh, si po lutesh për ta dhe sa shpesh je përkushtuar të lutesh për ta.

